



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:226919

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05743148

C.nr.309/15

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a.-sheshi “Nëna Terezë” nr.36 Prishtinë, kundër të paditurit R. R. P. nga fshati L./M., me objekt kontesti “Kompensim i dëmit material”, vlera e kontestit 887.47 euro, me datën 22.05.2024 ka mbajtur seancën përgatitore, ndërsa me datë 28 maj 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se paditësja Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a., **e ka tërhequr padinë** që identifikohet në këtë gjykatë me shenjën C.nr.309/15 e datës 15.12.2015, kundër të paditurit R. R. P. nga fshati L./M.,.

A r s y e t i m

Paditësja Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a.-sheshi “Nëna Terezë” nr.36 Prishtinë, me datë 15.12.2015 në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurit R. R. P. nga fshati L./M., me objekt kontesti “Kompensim i dëmit material”, vlera e kontestit 887.47 euro.

Lidhur me këtë, gjykata me datë 20.03.2018 ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi dhe të njëjtin ia ka dërguar të paditurit, i cili nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa me datë 22.05.2024 me fillim prej orës 10:20, gjykata e ka caktuar seancën përgatitore, ku prezent ka qenë vetëm i padituri.

Në procesverbalin e seancës përgatitore është konstatuar se paditësi nuk ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt pasi ftesa i është dërguar KEDS-it e jo KEK-ut, kurse i padituri ka qenë prezent personalisht dhe meqenëse nuk janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës, atëherë seanca është shtyrë për një datë tjetër.

Në po të njëjtën datë, pra me datë 22.05.2024, paditësi e ka dorëzuar në këtë gjykatë parashtrësën për tërheqjen e padisë në këtë çështje juridiko-kontestimore, duke e njoftuar gjykatën se në bazë të transaksioneve vërtetohet se sa i përket borxhit ndaj KEK Sh.A., i padituri

e ka përmbushur atë në tërësi, andaj ka kërkuar tërheqjen e padisë së parashtruar pranë kësaj gjykate.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3 par.1 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurë kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 261 par.2 të LPK-së, ku parashihet se: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohej për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*.

Bazuar në faktin se paditësi e ka tërhequr padinë, atëherë gjykata vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Andaj, në një gjendje të këtillë, Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 par. 2 dhe 3 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.309/15, datë 28.05.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

Udhëzim juridik: *Kundër këtij Aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261 par. 4 të LPK-së.*